

Në bazë të nenit 7, nenit 12 paragrafi 6, nenit 13 paragrafi 3, nenit 18 paragrafi 1 alinea 10, neni 20 paragrafi 1 alinea 4 nga Ligji i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonis së Veriut nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18,dhe 27/16), në përputhshmëri me konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, nr.02-2921/2 nga 30.05.2019, miratuar në seancën 23-të mbajtur më 30.05.2019, u përgatit Tekst i pastruar për Rregulloren e punës të Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizive.

Teksti i pastruar për Rregulloren e punës së Agjencionit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, i përmban: Rregulloren për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive nr.01-2949/1 nga 30.05.2019 për ndryshimin e Rregullores së punës të Agjencionit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

RREGULLORE E PUNËS SË AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE (Tekst i pastruar)

I.Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore e procedon punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Rregullorja për punën e Agjencisë rregullon fushëveprimin e punës, mbikëqyrjen, përgjegjësinë për punën e Agjencisë, organet e Agjencisë, mbrojtja e llogos, përpunimi dhe përdorimi i vulave të Agjencisë, mënyra dhe rregullorja e mbajtjes së seancave të Agjencisë, (në tekstin e mëposhtëm): mbledhjet publike, procedura për zgjidhjen dhe shkarkimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Agjencisë, procedura për aprovimin e akteve nënligjore, dhe akteve të tjera të paraqitura në ligjin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes, mbrojtja e pluralizmit dhe të përgjithshme të Agjencionit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, ritransmetimi i programeve kabllorike, vëzhgimin dhe masat për thyerjen e rregullave, mënyrën dhe procedurën për udhëheqjen e regjistrave në bazë ligjore dhe dispozita të tjera të rëndësishme për Agjencionin.

Neni 2

Agjencioni për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive është një rregullator i pavarur dhe organ me statusin e personit juridik me autorizime publike.

Republika e Maqedonis së Veriut është themeluesi i Agjencionit.

Prona dhe mjetet e punës së Agjencisë përdoren dhe menaxhohen nga vetë Agjencia. Selia e Agjencisë është në Shkup.

Neni 3

Agjencia ka vulën e vet dhe 2 (dy)vula (vula hyrëse dhe vula dalëse).

Vula e Agjencisë është në formë të rrumbullakët. Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonis së Veriut, dhe përreth saj në formë gjysmërrethi në gjuhën Maqedone dhe alfabetin e saj kilirik, si dhe gjuhën që e flasin më së pakti 20% e qytetarëve në faqen e saj është shkruar: "Republika e Maqedonisë së Veriut-Agjencioni për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive -Shkup me vend për shkrimin e nr të arhivës dhe datën për vërtetimin e dokumentacionit".

Vula pranuese e Agjencionit ka formë drejtëkëndëshe, dhe mbi të në gjuhën Maqedone dhe shkrimin kiril, si dhe në gjuhën që e flasin 20% e qytetarëve është shkruar: "Republika e Maqedonis së Veriut- Agjencia për Shërbime Audio dhe AudioviziveShkup",me vend për ta plotësuar me datën e pranimit, njësin organizative, nr, shtojca dhe vlera."

Vula dhe Vula katrore e pranimit (shtembil) vendosen në aktet e miratuara nga Këshilli i Agjencisë, si dhe në aktet që i sjell drejtori i Agjencisë, në përputhje me Dekretin për punë në zyrë dhe arhiv. Me aktin e sjellë nga Drejtori i Agjencisë, rregullohet mënyra e përdorimit të vulës dhe vulat dorëzohen te personat që i trajtojnë dhe i mbajnë ato.

Neni 4

Agjencia ka markën e vet tregtare (logon).

Marka tregtare (logoja) dhe mënyra e përdorimit të saj janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Agjencisë.

Neni 5

Emri i plotë i Agjencisë është “Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive” Emri i shkurtuar i Agjencisë është: ”ASHMAA”.

II.FUSHËVEPRIMI I PUNËS DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 6

Agjencioni në punën e saj angazhohet për: zhvillimin e agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, aprovimin e lirisë së fjalës, zhvillimin e produksionit të pavarur, nxitjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e identiteti kulturor, gjuhën dhe traditat e bashkësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, respektimin e kulturave dhe dallimeve të religjioneve, ngritjen e kulturës qytetare dhe dialogut me qëllim të ecjes përpara të një shoqërie të emancipuar, zhvillimin e medias së shkruar, konvergjencë e komunikimit elektronik, zhvillimin e konkurrencës në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizive dhe ritransmetimin e programeve nëpërmjet komunikimit të rrjetit elektronik dhe zhvillimit ekonomik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Agjencioni në përputhje me Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale duhet :

- të kujdeset për sigurimin e publikimit në punën e radiodifuzerëve,
- të inkurajojë lirinë e shprehjes,
- Kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të mediave audio dhe audiovizive, inkurajon dhe mbështet ekzistencën e audios së larmishme, të pavarur dhe të mëvetësuar dhe shërbime mediatike audiovizive të pavarura,
- Ndërrmer masa në pajtueshmëri me Ligjin për media audio dhe audiovizive në rast nëse paraqitet shkelje në ligj të rregullores, kushteve dhe obligimeve të gjitha këto të parapara me ligj,
- kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të minorenëve,
- i miraton aktet që dalin nga ky ligj,
- angazhohet për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në aspekt të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale,
- konstaton ekzistencën e palejuar të koncentrimit medial,
- vendos për ndarjen, marrjen ose vazhdimin e lejes për emitimet televizive ose në radio,
- ndërrmer masa për kufizim të kohës së transmetimit dhe ritransmetimit të mediave audio dhe audiovizive nga të tjera shtete në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtueshmëri me nenin 45 nga Ligji shërbime mediatike audio dhe audiovizive,
- sjell një listë me ngjarjet më të rëndësishme për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- nxit median e shkruar,
- kryen mbikëqyrje në përputhje me nenet 28 ,29, 30 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive ,
- i udhëheq regjistrat të aprovuar nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive,

- kryen kërkime dhe analiza për çështje specifike në terrenin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive,
- kryen matjet e shikueshmërisë ose dëgjimit të programeve, d.m.th shërbimet programore të transmetuesve nga Republika e Maqedonisë së Veriut,
- kryen dhe veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj.

Akte të miratuara nga Këshilli i Agjencisë, si dhe aktet që i sjell drejtori i Agjencisë, në përputhje me Dekretin për punë në zyrë dhe arhiv. Me aktin e sjellë nga Drejtori i Agjencisë, rregullohet mënyra e përdorimit të vulës dhe vulat dorëzohen te personat që i trajtojnë dhe i mbajnë ato.

Neni 4

Agjencia ka markën e vet tregtare (logon).

Marka tregtare (logoja) dhe mënyra e përdorimit të saj janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Agjencisë.

Neni 5

Emri i plotë i Agjencisë është “Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive” Emri i shkurtuar i Agjencisë është: “ASHMAA”.

II.FUSHËVEPRIMI I PUNËS DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 6

Agjencioni në punën e tij angazhohet për: zhvillimin e agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, aprovimin e lirisë së fjalës, zhvillimin e produksionit të pavarur, nxitje, zhvillimin dhe mbrojtjen e identiteti kulturor, gjuhën dhe traditat e bashkësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, respektimin e kulturave dhe dallimeve të religjioneve, ngritjen e kulturës qytetare dhe dialogut me qëllim të ecjes përpara të një shoqërie të emancipuar, zhvillimin e medias së shkruar, konvergjencë e komunikimit elektronik, zhvillimin e konkurrencës në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizive dhe ritransmetimin e programeve nëpërmjet komunikimit të rrjetit elektronik dhe zhvillimin ekonomik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Agjencioni në përputhje me Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale duhet:

- të kujdeset për sigurimin e publikimit në punën e radiodifuzerëve,
- të inkurajojë lirinë e shprehjes,
- Kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të mediave audio dhe audiovizive, inkurajon dhe mbështet ekzistencën e audios së larmishme, të pavarur dhe të mëvetësuar dhe shërbime mediatike audiovizive të pavarura,
- Ndërrmer masa në pajtueshmëri me Ligjin për media audio dhe audiovizive në rast nëse paraqitet shkelje të rregullores me ligj, kushteve dhe obligimeve të gjitha këto të parapara me ligj,
- kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të minorenëve,
- i miraton aktet që dalin nga ky ligj,
- angazhohet për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në aspekt të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale,
- konstaton ekzistencën e palejuar të koncentrimit medial,
- vendos për ndarjen, marrjen ose vazhdimin e lejes për transmetimet televizive ose në radio,
- ndërmerr masa për kufizimi të kohës së transmetimit dhe ritransmetimit të mediave audio dhe audiovizive nga të tjera shtete në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtueshmëri me nenin 45 nga Ligji për audio dhe shërbimet mediatike audiovizive,
- sjell një listë me ngjarjet më të rëndësishme për publikun e Republikës së

Maqedonisë së Veriut,

- nxit median e shkruar,
- kryen mbikëqyrje në përputhje me nenet 28, 29, 30 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive ,
- i udhëheq regjistrat të aprovuar nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive,
- kryen kërkime dhe analiza për çështje specifike në terrenin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive,
- kryen matjet e shikueshmërisë ose dëgjimit të programeve, d.m.th shërbimet programore të transmetuesve nga Republika e Maqedonisë së Veriut,
- kryen dhe veprimtari të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 8

Agjencioni në punën e tij është i pavarur nga organet e shtetit ose nga personat juridik dhe është i paanshëm ndaj tyre.

Agjencioni i kryen punët në përputhshmëri me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizive të shkruara në Ligjin për media, Ligji i Administratës publike, nëse në ligjin e Agjencisë nuk është paraparë ndryshe, ligjet e tjera dhe dokumentet strategjike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e medias dhe medimeve të shërbimeve audiovizive të nënshkruara ose të arritura nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Neni 9

Puna e Agjencisë financohet nga fondet e realizuara nga të ardhurat tarifat e parashikuara nga Ligji për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive nga fondet nga transmetimet me pagesë në përputhje me të njëjtin ligj, si dhe nga huatë dhe të tjera ndihma financiare dhe teknike. Agjencia ka llogaritë e saj bankare në bankat tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 10

Për realizimin e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësit të përcaktuara me ligj, Agjencia përmes organeve të saj (drejtori dhe këshilli i Agjencisë) sjell rregullore udhëzime, vendime, zgjidhje, përfundime, programe, si dhe konstaton qëndrime dhe propozime për realizimin e Ligjit të Agjencionit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive.

Rregullorja shtjellon disa dispozita të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Udhëzimi përshkruan mënyrën e veprimit në ekzekutimin e dispozitave të caktuara të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive Ligjin për Mediumet, akte nënligjore dhe rregulloret e tjera të miratuara në bazë të Ligjit.

Vendimi aprovon lejen për të zbatuar një ndryshim në strukturën e pronësisë së transmetuesit, për anulimin e vendimit me të cilën është lejuar zbatimi i një ndryshimi në strukturën e pronësisë, shpallja e një konkursi publik për dhënien e licencës për televizion ose radio transmetimi, për të revokuar licencën për transmetimet televizive dhe radio pa shpallje konkursi, për vazhdimin e të drejtës për transmetimet televizive dhe radios, për shkarkimin e drejtorit /zëvendës drejtorit të Agjencisë, për fillimin e procedurës për përcaktimin e ekzistencës së paligjshme të mediav, sipas detyrës zyrtare, për të krijuar një listë të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për të tjera pyetje në kompetencë të saj.

Vendimi paralajmëron botuesit e medias, ofruesit e shërbimeve audiovizive sipas kërkesës dhe operatorët e komunikimit elektronik dhe rrjeteve publike nëse konstatohet mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive dhe aktet nënligjore të mediave audiovizive të miratuara në bazë të rregullores, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga aktet e tjera ligjore të Agjencisë të zgjidhet me fshirjen nga regjistri në përputhshmëri me Ligjin për Media, po ashtu rregullojnë çështje të tjera në

brendi të kompetencave të Agjencisë, çështje administrative, si dhe çështje në fushën e marrëdhënieve të punës.

Në përfundim konstatohen qëndrimet e marra për çështje që Këshilli i Agjencionit i paraqet në seanca, konstatohen mendime mbi propozimet e akteve nënligjore dhe rregullave të nxjera në kompetencë të Agjencionit, sillet vendim për pyetje në lidhje me organizimin e punës së brendshme të Agjencionit, bëhet ndarja e detyrave nëpër sektor dhe njësitë e tjera të Agjencionit, miratohet propozimi i drejtorit për fillimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, miratohen propozimet e drejtorit për sjelljen e vendimit për ingjirencat e Këshillit (vendim për shpalljen publike të konkursit për dhënie licence për transmetim televiziv dhe radiotransmetim, vendim për ndryshimin e strukturës personale, e.t.j), dhe mbahet qëndrim për pyetje të tjera në lidhje me Agjencionin.

Plan programi përcakton pyetje të ndryshme në ingjirencat të Agjencionit për të cilat kërkohet përcaktimi i dinamikës dhe afateve. Programi gjithashtu përmban një plan financiar për punën e Agjencisë.

Me vendim urdhëron dhe ndalon veprimin në një situatë të caktuar e cila ka rëndësi të përgjithshme për ekzekutimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera, urdhërohet dhe ndalohet eksportimi ose botimi i dokumenteve nga arkivi i Agjencisë në situata të caktuara kur është e nevojshme, dhe të ngjashme.

III. Llogaridhënia për punën e agjencisë

Neni 11

Agjencia për punën e saj jep llogari në Kuvendin e Republikës së Maqedonis së Veriut duke paraqitur një raport mbi punën e saj.

Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia e publikon në faqen e saj të internetit dhe të njëjtën ja paraqet Kuvendit të Republikës së Maqedonis së Veriut për shqyrtim jo më vonë se 31 Mars të vitit aktual.

Raporti mbi punën e Agjencisë përmban:

- a) raportin vjetor për punën e Agjencisë për vitin paraprak dhe
- b) programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm.

Raporti vjetor i Agjencisë për vitin paraprak, nga paragrafi (3) pika a) të këtij neni përmban veçanërisht:

- raport mbi zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e kaluar, në të cilin duhet të tregohet realizimi i planit vjetor për mbikëqyrjen e programeve,

- raporti financiar për realizimin e planit financiar për vitin paraprak dhe llogari vjetore me të dhëna për realizimin e hyrjeve, shpenzimet, kërkesat, dhe obligimet për vitin e kaluar të grupuara sipas strukturës dhe strukturës organizative të Agjencisë dhe

- raporti i auditimit nga një auditor i pavarur ndërkombëtar i certifikuar nga Zyra Shtetërore e Auditimit për revizion, nëse është audituar nga ai, si dhe pozicionin e Agjencisë në lidhje me rezultatet e kryera nga kontrolli.

Me programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm nga paragrafi (3) pika b) e këtij neni përcakton detyrat dhe qëllimet që Agjencionin duhet të kryejë vitin e ardhshëm, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive që përmban në veçanti:

- programi i aktiviteteve të planifikuara dhe
- planin financiar për vitin e ardhshëm, i cili përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, për hyrje dhe shpenzimet e planifikuara të Agjencisë për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas organizimit strukturor të Agjencisë, si dhe investimet e parashikuara kapitale të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

IV ORGANET E AGJENCISË

Neni 12

Organet e Agjencisë janë Këshilli dhe Drejtori.
Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë.

Neni 13

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron anëtarët e Këshillit me propozim nga institucionet e autorizuar, si më poshtë:

- Dy shoqatat e gazetarëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut me shumicë të anëtarëve propozon një anëtar të Këshillit,
- Konferenca ndëruniversitare propozon një anëtar të Këshillit,
- Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut propozon një anëtar të Këshillit,
- Komisioni Parlamentar i zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut propozon dy anëtarë të Këshillit,
- Shoqata e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut propozon një anëtar të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit mund të jenë shtetas të republikës së Maqedonisë së Veriut me arsim të lartë, të kenë pesë vjet përvojë pune në profesione që janë dalluar në publik në fushën e komunikimit, gazetarisë, komunikimet elektronike, informatik, kultur, ekonomi, drejtësi apo fusha të tjera që është me rëndësi për ushtrimin e kompetencave të Këshillit

Anëtarët e Këshillit duhet të përfaqësojnë shumëllojshmërinë e nivelit më të mirë të një shoqërie me përfaqësim adekuat të të dy gjinive

Si anëtar të Këshillit nuk mund të emërohen:

- Deputet, anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, një person i cili emërohet nga Kuvendi ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, person i cili menaxhon njësinë e vetëqeverisjes lokale, drejtori ose anëtar i bordit menaxhues ose mbikëqyrës të një ndërmarrje publike,

- Personat që kryejnë detyra në organet e një partie politike ose bashkësi fetare,

- Person që posedon aksione, anëtar i një organi menaxhues, ose person i cili në mënyrë direkte ose indirekte ka interes në një person juridik të angazhuar në audio ose shërbime mediatike audiovizive ose në një kompani që kryen veprimtari të ngjashme (reklamimi, komunikimi elektronik, prodhim dhe shitje e audios dhe mallrave teknike audiovizive) etj, dhe kanë të bëjnë me shërbime mediatike audio /audiovizive dhe operatorët ose ofruesit e komunikimeve të rrjeteve elektronike publike,

- Person i cili është dënuar me burgim për një kohë më të gjatë se gjashtë muaj ose është nën masë të shqiptimit ndalim për të kryer profesionin, veprimtari ose detyrë për më shumë se gjashtë muaj deri në ndëshkim, derisa masa ose dënimi nuk i fshihet nga regjistri përkatës në përputhje me ligjin.

Për anëtarë të Këshillit mund të zgjidhen persona që punojnë në subjekte të tjera juridike, përveç personave juridik që mund të jenë në konflikt interesi në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive.

Anëtarët e Këshillit nuk lejohen nga transmetuesit, ofruesit e mediave audiovizive sipas kërkesës dhe nga operatorët e rrjeteve publike elektronike të transmetimit dhe ritransmetimit, të marrin dhurata, pranojnë shërbime, ose të hynë në marrëdhënie që do të sillnin ato në një konflikt interesi .

Neni 14

Anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë shtatë vjeçare.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të riemërohen.

Neni 15

V.Kompetencat e Këshillit të Agjencisë

Këshilli ka këto kompetenca:

- sjell vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënie licence për transmetime televizive dhe radiotelevizive,
- merr vendim për dhënien, revokim ose zgjatjen e licencës për transmetim televiziv ose radioteleviziv,
- sjell vendim që lejon, ose ndalon një ndryshim në strukturën e pronësisë së një transmetuesi,
- merr një vendim duke anuluar vendimin që lejon ndryshimin në strukturën e pronësisë së transmetuesit,
- merr vendim për fillimin e procedurës për caktimin e ekzistimit të paligjshëm të medias, sipas detyrës zyrtare,
- informon organin përgjegjës për të drejtat autoriale dhe të drejtat gjinore që janë shkelur,
- miraton akte nënligjore që dalin nga Ligji për Audio dhe shërbime mediatike audiovizive,
- miraton aktet e përgjithshme për punën e Agjencisë,
- miraton Rregulloren për punë në Agjenci,
- miraton llogarinë përfundimtare të Agjencisë,
- miraton raportin vjetor të punës për vitin paraprak dhe atë vjetor programin e punës për vitin e ardhshëm të Agjencisë të cilat janë pjesë integrale e raportit për punën e Agjencisë nga neni 8 i Ligjit për Audio dhe shërbime mediatike audiovizive,
- vendos të marrë masa për të kufizuar përkohësisht transmetimin dhe marrjen e shërbimeve mediatike audio ose audiovizive nga vendet e tjera në territorin e Republikës së Maqedonis së Verore,
- miraton një vendim për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonis së Veriut,
- miraton një Kod të Mirësjelljes për anëtarët e Këshillit dhe punonjësit në shërbimin profesional të Agjencisë,
- zgjedh dhe shkarkon drejtorin dhe nëndrejtorin e Agjencisë në përputhje me Ligjin për shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizivedhe sipas një procedure të përcaktuar në Rregulloren për punë të Agjencisë,
- jep miratim për marrjen e vendimeve të drejtorit të Agjencisë për posedimin e pasurisë, si dhe për punësimin dhe pushimin nga puna të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë,
- monitoron zbatimin e programit vjetor të punës së Agjencisë përmes raporteve tremujore të paraqitura nga Drejtori i Agjencisë,
- kryen dhe veprimtari të tjera të përcaktuara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Neni16

Këshilli miraton Planin e Prokurimit Publik të Agjencisë, ndryshimet dhe plotësimet, miraton planin financiar për vitin e ardhshëm,(që përmban të dhëna për arritjet e deritanishme), miraton ribalansin e vitit që vjen, jep pëlqimin për miratimin e vendimeve nga Drejtori i Agjencionit për kryerjen e procedurës për furnizim të përgjithshëm, bashkëfinancim të projekteve nga instrumenti për ndihmën e para- anëtarësimit në Bashkimin Evropian (IPA) .

Për kostot financiare në lidhje me funksionimin aktual të Agjencisë si shpenzimet të përgjithshme, tarifat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, pajtime për shtypin ditor /elektronik publik, mjete përfaqësimi, udhëtimet e biznesit dhe personale, vendos drejtori i Agjencisë, pa miratimin paraprak nga Këshilli.

VI. Mënyra dhe procedura për zhvillimin e seancave të këshillit të Agjencisë,Takimet publike

VI.1Seancat e Kuvendit

Neni 17

Për punën e ingjencave të saja të aprovuara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, Këshilli punon dhe vendos në seanca.

Këshilli është i detyruar të mbajë të paktën një seancë në muaj.

Këshilli punon në kворum prej të paktën pesë anëtarësh, dhe vendimet e aktet i miraton me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Vendimet dhe aktet e tjera të Këshillit nënshkruhen nga presidenti i Këshillit, ose në rast të pengesës së tij, Nënkryetari i Këshillit, jo më vonë se brenda tre ditëve nga dita e miratimit të tyre.

Në rast të mungesës ose pengesës së Presidentit të Këshillit ose Nënkryetarit të Këshillit, anëtarët e Këshillit autorizojnë një anëtar të Këshillit për të nënshkruar vendimin dhe aktet nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 18

Nëse një anëtar i Këshillit konsideron se ka një interes privat direkt ose indirekt në këmbimim të marrjes së vendimeve brenda kompetencës së Këshillit, anëtar i Këshillit është i obliguar të informojë Këshillin.

Në rastin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Këshilli vepron në përputhje me Ligjin për të parandaluar konfliktin e interesit.

Neni 19

Seancat e Këshillit thirren nga Presidenti i Këshillit me vetë iniciativë, në rast të mungesës ose pengesës së tij në iniciativë të nënkryetarit të Këshillit, përkatësisht anëtarit të autorizuar të Këshillit.

Kryetari i Këshillit është i detyruar të thërrasë një seancë të Këshillit me shkrim propozo tre anëtarë të Këshillit, ose me propozim me shkrim të Drejtorit të Agjencisë, jo më vonë se tre ditë nga dita e marrjes së propozimit.

Kryetari i Këshillit thërret seancë me një ftesë drejtuar anëtarëve të Këshillit me postë elektronike (E-mail).

Ftesa nga paragrafi 3 i këtij neni përmban vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës, me një propozim të rendit të ditës.

Ftesa dërgohet jo më vonë se një ditë para ditës së mbajtjes së seancës, si përjashtim më shkurtë në varësi të urgjencës së marrjes së vendimit për një çështje të caktuar.

Me përjashtim, kur kërkohet nga rrethana të veçanta, kryetari mund të thërrasë seancë të Këshillit me telefon. Anëtarët e Këshillit që nuk do të jenë në gjendje të marrin pjesë në seancë, për mungesën e tyre duhet të njoftojnë kryetarin e Këshillit, në e-mail ose telefon.

Neni 20

Kryetari i Këshillit kryeson seancat e Këshillit dhe e përfaqëson atë.

Në mungesë ose pengesë të Kryetarit të Këshillit, detyrimet e paragrafit 1 të këtij neni do të kryen nga Nënkryetari i Këshillit, dmth anëtar i autorizuar i Këshillit.

Neni 21

Në seancën e Këshillit merr pjesë Drejtori i Agjencisë, pa të drejtë vote, mund të marrë pjesë nëndrejtori dhe të punësuar të tjerë në shërbimet profesionale të Agjencisë, si dhe persona të tjerë të jashtëm.

Mbulimi mediatik i seancave të Këshillit nuk lejohet në rastet ku kemi raport informacioni me emërtim "përdorim të kufizuar"

Gazetarët që mbulojnë profesionalisht punën e Këshillit dhe të tjerë persona (të jashtëm) që janë të interesuar të marrin pjesë në seancë, duhet paraprakisht ta konfirmojnë prezencën e tyre pranë Agjencisë para fillimit të saj.

Neni 22

Rendi i dëtës i sesionit të Këshillit përcaktohet në fillim të sesionit me propozim të Kryetarit të Këshillit, ose në mungesë të tij nga nënkryetari i Këshillit ose nga anëtar i autorizuar nga vetë Këshilli.

Çdo anëtar i Këshillit në fillim të seancës, mund të propozoj, një pikë shtesë në rendin e dëtës.

Pas aprovimit të rendit të dëtës në seancë, Këshilli vazhdon me miratimin e procesverbalit nga seanca e mëparshme, në mënyrë që secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të vendos shënime në procesverbal.

Nëse vërejtjet e dhëna pranohen nga anëtarët e tjerë të Këshillit, ato përfshihen në procesverbal dhe konsiderohet i miratuar së bashku me sugjerimet e dhëna .

Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë që të futet në procesverbal mendimi kundërshtues.

Procesverbali që do të miratohet nga Këshilli në seancë do të nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit dhe personi që mbajti procesverbalin.

Në rast të mungesës së Kryetarit të Këshillit, procesverbali nga paragrafi 4 i këtij neni do të nënshkruhet nga zëvendës Kryetari i Këshillit, përkatësisht anëtar i autorizuar nga Këshilli.

Neni 23

Procesverbalet e mbajtura në seancën e Këshillit përmbajnë:

- numri rendor i seancës;
- data, ora dhe vendi i seancës;
- shënime të anëtarëve të tanishëm të Këshillit dhe personave të tjerë (punonjësit në shërbim profesional dhe jashtëm) në seancë;
- shënime për anëtarët e Këshillit që mungojnë, dhe arsyen për mosprezencën e tyre;
- deklarin dhe votimin e anëtarëve të Këshillit në pika individuale nga aprovimi i agjendës ditore ;

Të gjitha vendimet dhe konkluzionet që janë marrë ose miratuar individualisht dhe pikat e rendit të dëtës.

Neni 24

Seanca e Këshillit regjistrohet në mënyrë audio dhe vizuale.

Pas seancës së Këshillit përgatitet një kronikë.

Neni 25

Agjencia publikon në faqen e saj të internetit agjendën e seancave të Këshillit, jo më vonë se një ditë para dëtës së mbajtjes së saj Procesverbali i miratuar nga seancat e Këshillit me deklaratën dhe votimet e anëtarëve të Këshillit, kronokat e seancave, si dhe vendimet e miratuara dhe të tjerat akte, Agjencia i publikon në faqen e saj të internetit, brenda shtatë dëtëve nga dita e mbajtjes së seancës.

Neni 26

Materialet e përgatitura për seancat e Këshillit, shërbimi i ekspertëve të Agjencisë i paraqet te Kryetari i Këshillit të Agjencisë, zëvendës kryetarit të Këshillit dhe anëtarëve të Këshillit.

Materialet nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen përmes postës elektronike (e-mail), një ditë para dëtës së mbledhjes së Këshillit .

Në rast të pamundur për të paraqitur nga paragrafit 1 të këtij neni në mënyrë elektronike, ato dorëzohen në formë të shtypur (letër).

VI.2 Takime publike

Neni 27

Agjencia kryen aktivitete brenda kompetencës së sajë në mënyrë transparente, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të kenë njohuri për funksionimin e saj.

Neni 28

Agjencia është e detyruar të paktën një herë në tre muaj gjatë vitit të organizojë takime publike në mënyrë që tu mundësojë të gjithë personave të interesuar, ti shprehin qëndrimet e tyre dhe mendimet në lidhje me zhvillimin e mediave audio dhe audiovizive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në veçanti e tregut për shërbime audio dhe audiovizive në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe realizimi i aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave të programit vjetor të punës së Agjencisë.

Pikëpamjet dhe mendimet e marra nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me të njëjtën brenda shtatë ditëve nga data e mbajtjes së takimit publik mund të gjendet në faqen e internetit të Agjencisë.

Neni 29

VII.Emërimi dhe shkarkimi i Kryetarit zëvendës kryetarit të Këshillit të Agjencisë

Seanca konstitutive në të cilën zgjidhet Kryetari dhe zëvendës kryetari i Këshillit caktohet nga Kryetari, dmth nënkryetari i Këshillit nga përbërja e mëparshme.

Kryetari, përkatësisht zëvendës kryetari i Këshillit nga përbërja e mëparshme cakton seancat konstituive deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Agjencisë

Nëse Kryetari, kryesisht zëvendës kryetari i Këshillit nga përbërja e mëparshme nuk cakton një seancë konstituive brenda 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e Vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë ky vendim mirret me propozimin e të paktën 5 anëtarëve të emëruar.

Në rastin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, seancën plenare e drejton anëtari i sapo zgjedhur nga Këshilli me shumicë votash.

Neni 30

Këshilli zgjedh nga rradhët e anëtarëve të tij një Kryetar dhe Zëvendës kryetar.

Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë një kandidat për Kryetar të Këshillit.

Propozimi për kryetar Këshillit parashtrohet në seancën plenare, me gojë ose shkrim.

Propozimin për kandidat për Kryetar të Këshillit përmban Emrin dhe Mbiemrin e anëtarit të Këshillit arsyen e propozomit, si dhe emrin dhe mbiemrin e anëtarit të Këshillit që e paraqiti propozimin.

Renditja e kandidatëve për Kryetar të Këshillit përcaktohet sipas renditjes alfabetike të shkronjës së pare të mbiemrit.

Neni 31

Kryetari i Këshillit zgjidhet me votim publik.

Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit mund të bëhet me votim të fshehtë, nëse ashtu sjell vendim Këshilli. Propozim për votim anonim mund të sjellë çdo anëtar i Këshillit. Nëse votimi kryhet anonim, procesin e ndjek komision i përbërë nga tre anëtarë (kryetari i seancës konstituive dhe dy anëtarë të Këshillit).

Neni 32

Votimi për kandidatët për Kryetar bëhet sipas rendit të përcaktuar.

Secili anëtar i Këshillit voton vetëm për njërin nga kandidatët e nominuar.

Neni 33

Kandidati që mori shumicën e përgjithshme të votave nga anëtarët e Këshillit zgjidhet Kryetar i Këshillit.

Nëse në votimin e parë askush nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave, procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit përsëritet deri në zgjedhjen e Kryetarit.

Nëse tre ose më shumë kandidatë propozohen për Krytarë, votimi do të përsëritet për dy kandidatët që marrin numrin më të lartë të votave në votimin e parë.

Nëse në mesin e kandidatëve me numër më të lartë të votave ka kandidatë me të njëjtin numër votash, votimi përsëritet për të gjithë kandidatët me numër më të madh votash.

Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave, procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit përsëritet.

Neni 34

Pas zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit, kryetari vazhdon të kryesoj seancat konstituive, pas së cilës inicohet për zgjedhjen e zëvendës Kryetarit.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje procedurale në lidhje me zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit gjithashtu aplikohet dhe për zgjedhjen e zëvendës kryetarit.

Neni 35

Kryetari i Këshillit mund të shkarkohet në një seancë të Këshillit, në rastet e mëposhtme;

- në rastë përfundimit të mandatit të tij si anëtar i Këshillit të Agjencisë në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive,
- me kërkesën e tij,
- nëse e kryen me pakujdesi funksionin e Kryetarit të Këshillit, nëse nuk vepron në përputhje me dispozitat e Rregullores së punës të Agjencisë.

Propozim për shkarkimin e Kryetarit të Këshillit jep çdo anëtar i këshillit.

Kryetari i këshillit shkarkohet me vendim të marrë me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen gjithashtu për largimin nga puna të nënkryetarit të Këshillit.

VIII. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Agjencisë dhe Zëvendësdrejtorit

Neni 36

Këshilli zgjedh Drejtorin e Agjencisë (në tekstin mëposhtë: drejtor) përmes një konkursi publik.

Për tu zgjedhur Drejtor i Agjencisë, kandidati duhet të ketë arsim të lartë dhe përvojë pune mbi pesë vjet në fushën e komunikologëve, gazetari, komunikimeve elektronike, informatikë, kulturë, ekonomi ose drejtësi.

Këshilli është i detyruar të zgjedhë drejtorin e Agjencisë jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësit të tij.

Neni 37

Drejtori, bashkëshorti/ja, partneri i tij jashtëmartesor, si dhe të afërmit e ngushtë në një vijë të drejtë me gjurin e dytë, nuk mund të kenë pjesë të aksioneve, drejtëpërdrejtë ose indirekt në organizatat që kryejnë aktivitete ku bien ndeshë me kompetencat e Agjencisë.

Neni 38

Drejtori është i angazhuar profesionalisht në Agjenci me kohë të plotë pune.

Mandati i drejtorit është shtatë vjet.

Nëse mandati i drejtorit ka përfunduar, dhe procedura për zgjedhjen e një drejtori nuk është përfunduar, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në zgjedhjen e një drejtori, por jo më shumë se gjashtë muaj.

Neni 39

Drejtori organizon dhe menazhon punën e Agjencisë, përgjegjës është për funksionimin ligjor të Agjencisë dhe ka këto kompetenca:

- përfaqëson Agjencinë,
- nënshkruan kontrata në emër të Agjencisë,
- propozon aktet e përgjithshme për punën e Agjencisë,
- propozon rregulloren e Agjencisë raportin vjetor për punën dhe planin vjetor për punën e Agjencisë të cilat janë pjesë integrale e raportit vjetor për punën e Agjencisë nga neni 8 i ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive,
- propozon planin vjetor për vëzhgimin e mbikëqyrjes së programit dhe Metodologjia për kryerjen e mbikëqyrjes së programeve,
- miraton vendime për çështje brenda kompetencës së Agjencisë,
- lëshon çertifikata të regjistrimit të përcaktuara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive,
- merr masa në përputhje me Ligjin për Shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në rastet kur dispozitat e të njëjtit ligj janë shkelur ose rregulloret e miratuara mbi bazën e saj kushtet ose detyrimet e lejeve;
- propozon masa për kufizimin e përkohshëm të transmetimit dhe marrjes së shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive nga vendet e tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ,
- propozon vendime brenda kompetencave të Këshillit,
- propozon aktet nënligjore brenda kompetencave të Këshillit,
- propozon lista të ngjarjeve më të rëndësishme për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut ,
- u jep kompetenca personave të tjerë në kuadër të kompetencave të saja,
- vendos për punësimin dhe vendosjen e të punësuarve në profesionin përkatës në shërbim të Agjencisë
- kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin dhe rregulloren e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizive.

Drejtori është i detyruar të paraqesë raporte tremujore në Këshill mbi zbatimin e programit vjetor të punës së Agjencisë, si dhe çdo tre muaj raport për masat e marra në përputhje me Ligjin për Audio dhe Shërbimeve Audiovizive në rast të shkeljes së dispozitave të të njëjtit ligj, raport mbi aktivitetin ndërkombëtar të Agjencisë dhe aktivitetet e planifikuara në periudhën e ardhshme.

Drejtori ka të drejtë të autorizojë persona të tjerë të punësuar në Agjenci, brenda kompetencave dhe përgjegjësi të tij për menazhim në rast kur ai sështë prezent, po ashtu dhe zëvendës kryetari i Agjencisë ose për arsye të tjera nuk është në gjendje të kryejë punën e tij, me të gjitha ingirencat e parapara në nen 29 paragrafi 1 dhe 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive .

Neni 40

Në rast nevoje për punësim në trajnim profesional të Agjencisë, drejtori paraqet një propozim në Këshill për miratimin e vendimit të tij për hapjen e konkursit për marrëdhënie pune dhe për kryerjen e procedurës për punësim në sektorin përkatës. Pas marrjes së miratimit drejtori merr vendim për shpalljen e njoftimit për krijimin e një marrëdhënie pune dhe vendos për zgjedhjen e kandidatit për atë vend pune.

Drejtori i Agjencisë vendos për shpërndarjen e punonjësve në Shërbim profesional të Agjencisë.

Në rast kur punonjësi në shërbimin profesional të Agjencisë paraqet një kërkesë për dorëheqje nga kontrata e punës, drejtori do të informojë Këshillin për këtë, i cili vetëm e konfirmon anulimin e kontratës.

Këshilli miraton propozimin e Drejtorit për shkarkimin e punonjësit në shërbimin profesional të Agjencisë. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës mbi këtë bazë e sjell Këshilli.

Neni 41

Drejtori mund të shkarkohet nga Këshilli vetëm në këto raste:

- a) me kërkesë të tij;
- b) në rast të mosardhjes në punë për arsye shëndetësore më shumë se gjashtë muaj,
- c) pranim i funksionit ose pune që janë të pakrahasueshme me funksionin si drejtor;
- d) nëse është dënuar për vepër penale ku është shqiptur dënimi prej gjashtë muajve burg ose i është shqiptuar një masë sigurie ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtari ose detyrime, që zgjasim më shumë se gjashtë muaj,
- e) shkelje e dispozitave të ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ose rregullave të sjella nga ky Ligj që mund të vërtetohet nga raporti i punës së Agjencisë,
- ë) abuzim me funksionin sipas raportit të auditimit të përmendur në Nenin 8 të Ligjit për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive.

Neni 42

Drejtorit kundër të cilit po zhvillohet një procedurë shkarkimi i mundësohet mbrojtja para Këshillit.

Vendimi për shkarkimin e drejtorit mes tjerave duhet të përmbajë arsyet për shkarkimin e tij, shpjegim thelbësor dhe duhet të shpallet në veb faqen e Agjencisë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e sjelljes së vendimit.

Nëse drejtori është shkarkuar, procedura për zgjedhjen e drejtorit nuk ka përfunduar, funksionin drejtor do ta kryejë zëvendës drejtori në afat kohor prej jo më shumë se tre muaj.

Vendimi për shkarkimin e drejtorit është përfundimtar, dhe kundër tij mund të ngrihet një padi në gjykatën përkatëse, në përputhshmëri me Ligjin

Neni 43

Dispozitat e nenit 36,37,38,41 dhe 42 paragrafi 1, 2 dhe 4 zbatohen gjithashtu dhe për Zëvendës Drejtorin e Agjencisë.

Neni 44

Zëvendës drejtori i Agjencisë e zëvendëson drejtorin e Agjencisë në rast kur sështë prezent ose për arsye shëndetësore ose arsye të tjera kur ai nuk është në gjendje të kryejë funksionin, me të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë në udhëheqje .

Në bashkëpunim me Drejtorin e Agjencisë, zëvendës drejtori ka kompetencat e drejtorit, dhe kryen punë të cilat ai do tia besojë.

IX.Procedura për miratimin e akteve nënligjore dhe akteve të tjera që dalin nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive

Neni 45

Agjencia e Shërbimeve të Mediave Audio dhe Audiovizive sjell akte nënligjore dhe akte të tjera që dalin në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive dhe Ligjin për Media me propozim të drejtorit.

Procedura për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe akteve të tjera të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të përbëhet nga dy faza: drafti dhe propozimi.

Neni 46

Aktet nënligjore dhe aktet e tjera brenda kompetencës së Agjencisë, i propozon drejtori i Agjencisë dhe i paraqet për shqyrtim dhe miratim në seancën e Këshillit të Agjencisë.

Këshilli pas shqyrtimit paraprak dhe dhënis së mendimit të tij me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të Këshillit, i miraton aktet nënligjore dhe aktet e tjera brenda kompetencës së Agjencionit dhe të njëjtat i publikon ato në faqen e saj të internetit në përputhje me nenin 25 paragrafi 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 47

Agjencia para se të miratojë ose ndryshojë një akt nënligjor brenda kompetencës së saj, si dhe para se të sjellë programin vjetor të punës për vitin e ardhshëm, e publikon aktin nënligjor të propozuar përkatësisht programin vjetor të punës të propozuar në mënyrë që të sigurojë një dëgjim publik dhe të mundësojë të gjitha palët e interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe sygjerimet e tyre në lidhje me aktet nënligjore të propozuara ose programin vjetor të propozuar për punë për vitin e ardhshëm.

